



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 17, datë 25.06.2025

P Ë R

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: "GODINË BANIMI DHE SHËRBIMESH 2 DHE 9 KATE MBI TOKË, ME 3 KATE PARKIM NËNTOKË", ME VENDNDODHJE NË RRUGËN E SARACËVE, BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit" e ndryshuar, me propozim të subjekteve zhvilluese shoqërive "General Construction & Co.85" sh.p.k. dhe "Emigres" sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

V E N D O S I:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: "Godinë banimi dhe shërbimesh 2 dhe 9 kate mbi tokë, me 3 kate parkim nëntokë", me vendndodhje në Rrugën e Saracëve, Bashkia Tiranë, me subjekte zhvilluese shoqëritë "General Construction & Co.85" sh.p.k dhe "Emigres" sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkuar vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
ENEA KARAKAÇI



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 25/03 2026